

Komuna e Pejës: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Pejës udhëhiqet nga Ali Berisha nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Për z.Berisha, po e përmbyll mandatin e dytë qeverisës (2007-2009 dhe 2009-2013).
2. Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Peja ka 96.450 banorë. Kjo komunë për nga numri i popullsisë rreshtohet e katërta në vend pas Prishtinës, Prizrenit dhe Ferizajt.¹
3. Komuna e Pejës ka gjithsej 14 drejtori. Për dallim nga komunat e tjera të vendit, në këtë komunë është e formuar edhe Drejtoria për Integritet dhe Diasporë, si dhe Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Juridike. Ndërsa Kuvendi Komunal i Pejës përbëhet nga 41 asambleistë. Përfaqësimi i partive politike në kuvend është relativisht i gjerë. Kësisoj, 13 asambleistë janë nga AAK, nëntë janë nga LDK, gjashtë janë nga PDK-së, katër nga LDD, dy nga AKR, dy nga PSD, një nga (PD), një nga IRDK, një nga VAKAT, një nga SDP dhe me një asambleist përfaqësohet SDA.
4. Në hulumtimin e opinionit publik të realizuar nga UNDP në fund të vitit 2012 i përmbledhur në raportin “Mozaiku i Kosovës”, tregohet se vetëm pak më shumë se gjysma e banorëve të Pejës, rreth 52%, besojnë se autoritetet e tyre lokale kanë kapacitet për të zgjidhur problemet në komunën e tyre. Ndërsa, 14% mendojnë se këto probleme mund të zgjidhen vetëm nga pushteti qendror.²
5. Ndërsa nga ana tjetër, në hulumtimin e zhvilluar nga Instituti GAP në fund të vitit 2009, problemet më të mëdha në këtë komunë kanë qenë mungesa e sigurisë në shkollë, prerja e pyjeve, ndotja e lumit, mungesa e ndriçimit publik dhe problemet në komunikacion.³

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2012. Fq 134. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Albanian_216_825.pdf

³ Instituti GAP. Raporti komunal. Komuna e Pejës. 2009. Fq 3. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/71448_Peja-raporti%20komunal.pdf

Problemet kryesore të Komunës së Pejës 2013

- 1. Problemet me mungesë të objekteve shkollore.** Problem për Komunën e Pejës konsiderohet mungesa e objektit për shkollën e mesme të mjekësisë. Mbi një mijë nxënës të kësaj shkolle e zhvillojnë mësimin në objektin e shkollës fillore “Ramiz Sadiku”. Edhe pse komuna ka premtuar se shkollën e mjekësisë do të fillojë së ndërtuari para pesë viteve, kjo nuk ka ndodhur. Afaristi nga Peja, Ramiz Kelmendi me fondet e tij ka nisur të ndërtojë këtë shkollë, por duke vënë kusht që emri i babait të tij t’i vihet shkollës.⁴ Ky kusht është pranuar nga ana e përgjegjësve të komunës, por jo edhe nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Kjo ka bërë që z. Kelmendi të heqë dorë nga ndërtimi i mëtutjeshëm i shkollës. Përveç këtij objekti, edhe shkolla “Xhemajl Kada” në zonën e quajtur “7 shtatori” është e mbingarkuar me nxënës. Kjo shkollë akoma punon në tri ndërrime. Një problem tjetër sa i përket objekteve shkollore është edhe shkolla e mesme teknike “Shaban Spahiu” e cila është e shpërndarë në katër pjesë të ndryshme të qytetit. Një objekt i kësaj shkolle gjendet afër hekurudhës, objekti i dytë afër stacionit të policisë, një tjetër gjendet afër Fakultetit të Biznesit, si dhe objekti i katërt gjendet afër objektit të burgut. Në këtë komunë hasen dhe objekte shkollore të vjetra të cilat kërkojnë riparim apo edhe ndërtim të ri të tyre siç janë shkolla fillore “8 marsi” që gjendet afër qendrës zejtare, shkolla fillore “28 nëntori” në Zllapek dhe shkolla fillore “Asdreni” që gjendet në rrugën që të shpije te spitalit i qytetit. Shkolla fillore “Lidhja e Prizrenit” nuk ka ngrohje qendrore ku disa herë gjatë dimrit është ndërprerë mësimi për këtë arsye. Gjimnazi “Bedri Pejani” në Pejë është i dëmtuar e veçmas tavani i cili rrezikon të shembet. Njësoj qëndron gjendja edhe në shkollën “Vaso Pashë Shkodrani” ku muret janë të dëmtuara dhe rrezikojnë të shemben. Në Novosellë dhe Lutogllavë janë ndërtuar shkolla të reja me kapacitet edhe më të madh se numri i nxënësve që kanë këto dy lokalitete. Për shkak se nga fshati Novosellë vie nënkryetari i Kuvendit të Kosovës z.Xhavit Haliti, kurse nga fshati Lutogllavë Zëvendëskryeministri dhe Ministri i Drejtësisë z.Hajredin Kuçi, qytetarët dyshojnë se këto dy shkolla moderne, me kapacitete më të mëdha se sa numri i nxënësve, janë ndërtuar si rezultat i ndikimit politik të këtyre dy personaliteteve.
- 2. Mungesa e rrjetit të kanalizimeve nëpër fshatra.** Përveç fshatrave të Lugut të Baranit, fshatrat e tjera nuk kanë rrjet të kanalizimit. Rrjetet e kanalizimeve mungojnë në fshatrat Buçan, Dobovë, Jabllanicë, Kosturiq, Kryshec, Leshan, Logjë etj. Banorët

⁴ Gazeta “Tribuna”. 18 prill 2013. Autor, Saranda Ramaj. Kusht për ndërtimin e shkollës e ka vene emrin e babait te tij. Burimi: <http://www.gazetatribuna.com/?FaqeID=2&LajmID=5006>

e këtyre zonave kanë hapur gropa septike të cilat gjatë sezonit të verës kundërmojnë. Përveç këtij problemi, zonat urbane kanalizimet i derdhin në shtratin e lumit Lumëbardh. Kjo përndikon në ndotjen e këtij lumi dhe në përhapjen e erërave të këqija, erëra këto që hasen edhe në afërsi të hotel “Dukagjinit”. Në hulumtimin e opinionit të qytetarëve nga ana e organizatës DEMI/USAID, 37% e banorëve të Pejës janë shprehur të pakënaqur me gjendjen e kanalizimeve në vendbanimin e tyre.⁵

- 3. Prerjet e pyjeve.** Komunitetet e Dukagjinit në përgjithësi, por në veçanti pyjet e Komunës së Pejës i janë ekspozuar prerjeve të vazhdueshme, kryesisht në mënyrë ilegale. Në disa raste janë prerë edhe pishat e mbjella dekada më herët. Zona më e prekur nga kjo dukuri vlerësohet rajoni i fshatrave të Rugovës. Në zonën e quajtur të Rrosuajve janë prerë me shumë se 10 hektarë me pisha të mbjella në vitet ‘70-ta.
- 4. Mungesa e ujit të pijes.** Në fshatin Radavc, nga ku buron uji i Lumëbardhit, ka mungesë të ujit të pijes. Përveç kësaj, reduktimet në disa rajone të Pejës janë të shpeshta, veçmas gjatë sezonit të verës. Me reduktime përballen edhe fshatrat si Pavlan, Nabërgjan, Loxhë dhe zona e qytetit tek “Varrezat e Kakariçit” etj. Sipas hulumtimit të UNDP-së, 49% e familjeve të lidhura me ujësjellësin publik, në krahasim me mesataren e Kosovës 42%, kanë furnizim të pakufizuar të ujit. Nëntë përqind kanë ndërprerje të furnizimit me ujë prej 1 deri në 4 orë në ditë, 13% prej 5 deri në 10 orë në ditë, kurse 26% kanë thënë se ndërprerjet e ujit në vendbanimin e tyre zgjasin më shumë se 11 orë në ditë.⁶
- 5. Eksploatimi ilegal i zhavorrit.** Shtrati i Lumëbardhit në pjesën që përshkon fshatrat e Grykës së Rugovës, në vazhdimësi shfrytëzohet për nxjerrjen e zhavorrit nga shumë kompani të palicencuara për kryerjen e veprimtarive të tilla. Katër seperacione të tilla gjenden edhe në grykën e quajtur Brestovik në lumin Shushica. Kjo dukuri besohet të ndikojë në shkatërrimin e shtretërve të lumenjve dhe në mundësinë e daljes së tyre nga shtrati.
- 6. Mungesa e qendrave të mjekësisë në fshatrat e Rugovës.** 15 fshatra sa numëron rajoni i Rugovës nuk kanë ambulancë shëndetësore. Banorët e këtyre fshatrave për një shërbim

⁵ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 23. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

⁶ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. Fq 116. 2012. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

elementar shëndetësor detyrohen të shkojnë në qendrat e mjekësisë familjare në qytet. Gjatë kohës së dimrit disa nga fshatrat e kësaj ane bllokohen për ditë të tëra nga bora, çka u pamundëson atyre shkuarjen deri te ambulancat e qytetit për marrjen e shërbimeve shëndetësore. Komuna nuk ka nisur me ndërtimin e asnjë objekti shëndetësor në këtë anë. Duke e parë nevojën e një qendre të tillë, kompania private “Magra Austria” ka ndërtuar një objekt me qëllim që të shfrytëzohet për Ambulancë. Komuna nuk ka mundur që ta dërgojë stafin mjekësor në atë objekt.

- 7. Hedhja e mbeturinave në lumin “Çokalica”.** Pothuajse i gjithë shtrati i lumit “Çokalica” është i mbushur me mbeturina të hedhura nga ana e qytetarëve. Për shkak të gjerësisë së vogël ky lum bllokohet lehtë nga hedhja e tyre. Ky lum përshkon qytetin e Pejës, ndërkaq rrjedh nga zona malore “Asllan Çeshma”.
- 8. Rruga e dëmtuar dhe e ngushtë në relacionin Pejë – Terstenik.** Kjo rrugë është e gjatë afërsisht 15 km dhe e gjerë më pak se 4 m. Dy automjete nuk mund ta përshkojnë rrugën në kahje të ndryshme. Aksidentet me dëme materiale në këtë rrugë janë të përditshme. Rruga përveç që është e ngushtë, ajo është përplot gropa.
- 9. Mungesa e ndriçimit publik.** Komuna e Pejës ka arritur gjatë dy viteve të fundit të rregullojë të ashtuquajturin shtegu i gjelbër i cili shfrytëzohet nga qytetarët për ecje, vrapim si dhe çiklizëm. Ky shteg është afërsisht 9 km i gjatë. Problem për qytetarët paraqet mungesa e ndriçimit publik. Mungesa e ndriçimit e bënë shtegun e shfrytëzueshëm vetëm gjatë orëve të ditës. Në vazhdim, pa ndriçim publik është “Parku i Madh” në qendër të qytetit.

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

- 1. Ruajtja e zejeve të vjetra në “Çarshinë e Gjatë”.** Bashkëbiseduesit kanë kërkuar nga Komuna që kujdes të veçantë t’i kushtojnë zejeve të vjetra të cilat janë të koncentruara në “Çarshinë e Gjatë”. Komuna në këtë vit ka shpërndarë subvencione për këta zejtarë dhe nga bashkëbiseduesit është adresuar nevoja që kjo të bëhet praktikë e rregullt edhe në vitet në vijim.
- 2. Bjeshkët e Rugovës.** Komuna e Pejës ka potenciale të mira për zhvillimin e turizmit dimëror dhe veror, veçmas në zonën e


bjeshkëve të Rugovës. Aktualisht në këtë zonë nuk ka ujë të pijes në formë të rregulluar, mungon rrjeti i kanalizimit, rrugët janë përgjithësisht të pashtruara në asfalt si dhe ka mungesë të Ambulancës. Përveç këtyre, kësaj zone i mungojnë teleferikët të cilët besohet që do të ndikojnë në shumëfishimin e turistëve në të gjitha sezonat. Ky rajon i është ekspozuar edhe shkatërrimit masiv të pyjeve nga prerja ilegale e drunjëve. Bashkëbiseduesit nga kjo komunë kanë kërkuar nga udhëheqja e ardhshme komunale që rëndësi të veçantë t'i kushtohet kësaj zone.

Trendet Buxhetore në Komunën e Pejës

Komuna e Pejës për vitin 2013 ka planifikuar 19.7 milion euro buxhet ndërsa ky vit shënon edhe buxhetin më të madh në katër vitet e fundit për këtë komunë. Krahasuar me vitin 2010, buxheti i Komunës së Pejës ka shënuar një rritje prej 4 milion euro (26%). Të hyrat vetanake të kësaj komune kanë shënuar rritje të vazhdueshme në tri vitet e fundit dhe në vitin 2012 kanë arritur në 2.9 milion euro. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm⁷ ka gjetur se komuna nuk ka softuer për regjistrimin e të hyrave, gjë që rritë rrezikun për manipulim.

⁷ ZAP, Raporti i Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Pejës për Vitin e Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 07 Gusht 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPE_2012_Shqip_682693.pdf

Figura 1. Buxheti i Komunës së Pejës- 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?peje/2013#/~-/peje>

Në bazë të grafikonit të mëposhtëm rreth ndarjeve buxhetore, shohim se shpenzimet kapitale në vitin 2012 kanë pasur një rënie prej 1 milion euro, ndërsa në po të njëjtin vit, mallrat dhe shërbimet janë rritur për 674 mijë euro (34%). Kur jemi tek shpenzimet, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në vitin 2012 ka gjetur shumë mangësi në menaxhimin e financave p.sh. në projektin "Riparimi i tërësishëm në shkollën Vaso Pashë Shkodrani", dritaret me çmim 120 euro janë paguar me çmim 230 euro. Në vazhdim, Auditori ka gjetur se komuna: 1) ka hyrë në kontrata pa zotime të mjaftueshme; 2) pagesa të faturave pa përshkrim të punëve; 3) ka dhënë bursa studimi për studentë me notë mesatare 6.7 derisa kriteri ka qenë 8.0 etj. Në vazhdim, komuna ka arsyetuar fatura për akomodim në dy konferenca në Budvë dhe udhëtim në Suedi përderisa

këto shpenzime kanë qenë të paguara nga Banka Botërore, përkatësisht Komuna Horby (Suedi).

Figura 2. Trendet e ndarjeve buxhetore 2010-2013



Në bazë të Kornizës Afatmesme Buxhetore, shohim se komuna e Pejës vlerëson se do të ketë një ngritje të lehtë në buxhet si pasojë e rritjes së të hyrave vetanake dhe grantit qeveritar. Kjo rritje e buxhetit planifikohet të shpenzohet në shpenzime kapitale dhe subvencione dhe transfere.

Tabela 1. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve 2014-2016

Të Hyrat	2014	2015	2016
Të Hyrat Totale	19.087.593	19.628.016	20.055.878
Të hyrat vetanake	3.045.000	3.136.350	3.199.077
Grantet	16.042.593	16.491.666	16.856.801
Shpenzimet Totale	19.087.593	19.628.016	20.055.877
Pagat dhe Mëditjet	10.512.912	10.512.912	10.512.912
Mallrat dhe Shërbimet	3.050.133	3.050.133	3.050.133
Shpenzimet Komunale			
Subvencionet dhe Transferet	350.000	360.885	372.108
Shpenzimet Kapitale	5.174.548	5.704.086	6.120.724

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës huluntuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Pejës është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.